



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 10003 Prot.

Tiranë, më 28.09. 2018

URDHËR

NR. 616, DATË 28.09. 2018

PËR  
HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT “MASTER  
PROFESIONAL” NË “SISTEMI I INFORMACIONIT GJEORAFIK TË  
APLIKUAR”, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69, dhe 75 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master profesional” në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”, që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master profesional” në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Programi i ciklit të dytë të studimit “Master profesional” në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”, financohet nga të ardhurat e Universitetit të Tiranës, në mënyrë të përhershme.
3. Veprimtaria akademike në programin e ciklit të dytë të studimit “Master profesional” në “Sistemi i Informacionit Gjeografik të Aplikuar”, fillon në vitin akademik 2018-2019.
4. Universiteti i Tiranës t’i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin “Universiteti i Tiranës”.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i Tiranës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

  
Lindita Nikolla

